



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E NOVOBËRDËS - OPŠTINA NOVO BRDO
DALËSE - IZLAZNA

Nr/Br 01/522
Më/Dana 22.04.2024.

NOVOBËRDË - NOVO BRDO



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPŠTINA OPŠTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë të dispozitave të nenit 41 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

FTOJ

Mbledhjen e Katërt të Kuvendit komunal e cila do të mbahet më: 30.04.2024(E martë) duke filluar ne ora 10:00.

Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

Rendi i ditës

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së;
2. Raporti Financiar i tremujorit të parë Janar – Mars 2024;
3. Bartja e mjeteve nga të hyrat vetanake nga viti 2023 në vitin 2024;
4. Raportim i Kompanisë Ekologjia për punët e kryera nga Kompania Ekologjia në terren;
5. Aprovimi i memorandumit të bashkpunimit ne mes të Komunës së Novobërdës dhe Kompanis "Titan";
6. Të ndryshme;

Mbledhja do të mbahet në hapësirat e K.K-së në Novobërdë.

Më:22.04.2024


Në: Novobërdë

Kryesuesë e Kuvendit
Mirjana Simijonović



4. Raportim i Kompanisë Ekologjia për punët e kryera nga Kompania Ekologjia në terren;
5. Aprovimi i memorandumit të bashkpunimit ne mes të Komunës së Novobërdës dhe Kompanis "Titan";
6. Të ndryshme;

Mbledhja do të mbahet në hapësirat e K.K-së në Novobërdë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

ZYRA E KUVENDIT/KANCELARIJA SKUPŠTINE

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e tretë e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 29.03.2024, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja e Kuvendit znj.Mirjana Simijonovic, zv.kryesuesi i kuvendit zt.Ramush Mehmeti, antarët e Kuvendit: Stojan Stanojevic, Dragana Dimic, Pranvera Kastrati Gashi, Negovan Jovanovic, Milica Jovanovic, Selatin Nuhju, Dobrivoje Djordjevic, Abdyl Gashi, Vlora Vllasaliu, Stefan Kovacevic, Violeta Milosevic, Dragana Dimic, Drejtori i Financave Milos Denic, Drejtori i Arsimit Sinisa Dimic, Menaxheri i kompanisë Ekologjia,përfaqësuesi i OSBE-së, zyrtarë komunal dhe qytetarë.

Kryesuesja e Kuvendit pasi pershendeti të pranishmit tha: konstatoj korumin prezent janë 14 anëtarë nga 15 anëtarë gjithësej të Kuvendit, kemi korum për punë dhe vendimarrje dhe po fillojm mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Shqyrtimi i Mundesis për planifimin e marrjes se masave për mbrojtjen e rrugve lokale dhe qytetarve qe i perdorin ato rrugë;
3. Informim Rrethë Aktiviteteve të mbajtura me rastin e 8 Marsit;
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i kerkesave të qytetarve per ndrrim destinim të tokes;
5. Raport i Drejtorisë së Bujqësisë për perfituesit e subvencioneve nga Ministria e Bujqësisë dhe Komunës së Novobërdës;
6. Të ndryshme;

Kryesuesja i pyeti të pranishmit se a pajtohen me këtë rend të ditës?.

Pasi nuk pati propozime shtesë rendi i ditës u aprovua me 13 vota për dhe 1 nuk ka votuar.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati vërejtje procesverbali u aprovua me 13 vota për, 1 nuk ka votuar.

Pika e dytë: Shqyrtimi i Mundesis për planifimin e marrjes se masave për mbrojtjen e rrugve lokale dhe qytetarve qe i perdorin ato rrugë;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë, pasi që Drejtori nuk është prezent.

Stojan Stanojevic pasi pershendeti të pranishmit tha: kjo asht hera e dyt apo e tret qe kjo po vie ne kuvend per diskutim dhe askush nga ekzekutivi nuk vie me prezentu e para nuk kemi asgje materjak ketu per

ketë pikë dhe nuk mujm te diskutojm dhe e dyta nuk është prezent askush nga drejtoria e sherbimeve publike duhen te jenë me serjoz se kjo është hera e katert qe askush nuk vjen ne kuvend per prezentimme ketë duhet te them se po e neglizhojn kuvendin dhe qytetaret qe na kanë votuar ju kisha lutur juve si kryesuse qe te bisedoni me kryetarin dhe unë se antar i kuvendit qe te sanksionoj ketë qeshtje per mos pjesmarrje të drejtorve në mbledhje, ketu askush nuk mundet me lujtë me qytetaret si dhe me 15 antaret e keti kuvendi.

Pranvera Kastrati Gashi pasi pershendeti të pranishmit tha: pajtohem plotësishtë me fjalët e kolegut, ashtu siç diskutova edhe në KPF për çdo mbledhje mungojnë Drejtorat kemi shumë mosrespktim ne si antarë, kush është Drejtori që ne tja votojm piken kur ai nuk është prezent. Është jashtzakonisht e padrejt, unë për këtë pikë nuk votoj fare.

Stojan Stanojevic tha: ju kisha lutur qe edhe pse e votuam rendin e dites qe kjo pik te hinë në te ndryshme per diskutim.

Kryesuesja tha: atëher pasi që drejtori nuk është prezent këtë pikë e shtyem për mbledhjen e ardhshme. Me shumic votash kjo pikë aprovohet që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhes.

Pika e tretë: Informim rreth Aktiviteteve të mbajtura me rastin e 8 Marsit;

Kryesuesja tha: pasi askush nuk është prezent që të raportoj edhe këtë pikë e shtyem për mbledhjen e radhes.

Me shumic votash aprovohet kjo pikë që të shtyhet për mbledhjen e radhes.

Pika e katërt: Shqyrtimi dhe aprovimi i kerkesave të qytetarve per ndrrim destinim të tokes;

Për këtë pikë Kryesuesja ja kaloi fjalën Zyrtarit të drejtoris së Urbanizmit zt.Sinisa Markovic .Sinisa Markovic pasi pershendeti të pranishmit tha: qytetaret tanë kanë bërë kerkes per shendrrim të tokes Bujqesore në tokë ndertimore ku pastaj keta qytetar do të paisen me leje ndertimi ,siq e shiheni drejtoria e inspeksionit asht ne teren de asnje ndertim pa leje nuk i lejon qe te ndertohen ,kerkesat e qytatarve gjithsej janë 96 kerkesa per parcela në zona te ndryshme ku janë te plotesuara me dokumentacionin në bazë te rregullores per ndryshim destinim.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Abdyl Gashi pasi pershendeti të pranishmit tha: po e shohim një list ku janë 98 aplikime parcelash por u dasht me u dergu me kohë që edhe ne me pa pas kohë me analizu dhe pse me u fut kështu bashk me u votu, nuk kemi aq kapaicet të madhe në mënyrë që të diem se për cilat parcela po bëhet fjalë dhe për këtë arsye edhe mundet dikush të ndeshkohet padrejtësishtë. Kemi pas edhe më herët këto problem ku kemi votuar kunder për arsye se nuk kemi pasur material me kohë. Kështu që kerkoj që materiali të vij 7 dite më heret ashtu si ftesa.

Ramush Mehmeti pasi pershendeti të pranishmit tha: unë mendoj se kjo list e materialeve i paska të gjitha me emer mbiemer, numrin e parces dhe zon kadastrale, dosja e kompletuar ka shumë material dhe është problem që tju shperndahet të gjithëve. Drejtori ka pergjegjësi nese ka shkelje ligjore juridike. Kjo është mirë pasi që qytetarët kanë interesim me bë legalizim të pronave dhe mendoj se si pikë është e pranueshme pasi që bëhet fjalë për qytetarët e Komunës sonë.

Selatin Nuhii pas pershendeti të pranishmit tha: une e kam një pyetje keto parcela a janë në bazë të planit urbanistik të Komunës të bëhet shendrrimi i këtyre pronave prej bujqësore në ndertimore.

Procesverbali i Kuvendit

Sinisa Markovic tha:nuk e di se a jeni të informuar se sa i perket olanit urbanistik kemi vetem per nje zon dhe ajo zonë është per zonen katastrale Boston ndersa sa i perket planit urbanistik të pergjithshem është ne fazen e punimit ku janë duke punuar dhe gjat punimit në planin urbanistik do te hin edhe keto kerkesa dhe parcela ,Drejtori i ka verifiku të gjitha keto parcela se a janë në rregull dhe ka verifiku qe keto parcela janë ne kategorin e klases 5 dhe 6 dhe janë te kompletuara me dokumente dhe siq e dini keto parcela dhe vendime dergohen edhe në ministri per verifikim.

Pasi nuk pati diskutime tjera me 12 vota për, 2 antarë nuk kan votuar aprovohet kjo pikë dhe mirret vendimet për ndryshim dhe ridestitim të pronave.

Pika e pestë: Raport i Drejtorisë së Bujqësisë për perfituesit e subvencioneve nga Ministria e Bujqësisë dhe Komunës së Novobërdës;

Për këtë pikë Kryesuesja ja kaloi fjalën Drejtorit të Bujqësisë.

Dragan Peric tha: ju kerkoj falje qe materjalin nuk jam kamë dergu në email lista qe jam shperndava para fillimit të mbledhjes është lista e perfitusve të subvencioneve nga Ministria e Bujqesis.

Ndersa sa i perket subvencioneve nga komuna ende nuk kemi nje list perfundimtare të perfitusve të subvencioneve të komunes,une kamë pregadit vetem listen e atyre qe kanë apliku per subvencione komunale,numri i aplikanteve per maqina bujqesore ashtë 173 fermer ndersa per kultivator është,116 prej ketyre fermeret qe kanë kaluar neper komisionin per verifikim te dokumentacionit per maqina bujqesore është 88 ku ka ende dokumentacion per te verifikuar,po ashtu dokumentet e verifikimit per motokultivator është i pa verifikuar.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Abdyl Gashi tha: listen që kanë aplikuar ne nivelin qendror në Ministri e kemi por listen për subvencione Komunale asnjëher nuk e kemi pasur për arsye se të gjitha aplikacionet nuk i plotësojn kriteret dhe ka përfitues që kanë përfitur shumë herë dhe i kan shit ato paisje, shumë herë është përmendur që të formohet një komision në mënyrë që ti vertetojnë se a i kanë apo i kanë shit. Këtë komision që e permendi Drejtori se është formuar një komision shtesë për 5 ari kush nuk i plotëson kërkesen nuk besoj që qendron pasi asnjëherë nuk kemi pasur list dhe as nuk besoj që do të kemi. Unë kam propozuar që mos të subvencionohet vetem me paisje për arsye të votave por ti shikojn edhe Komunat tjera si subvencionojn në qumshtë ose krerë gjedhe e jo të ndahen këto paisje më shumë për vota. Koltivatorat janë bërë hitë në Komunën tonë.

Dragan Peric tha: sa i perket listes ju thashë qe mund të ju afroje sa her qe te ket nevoj se ashtë publike,por me duhet te them se ne duhet të subcicionjm ne prodhimin e qumshtit dhe te mishit,unë e kam pregaditur nje plan te punes se si duhet te jet subvecionimi,

Stojan Stanojevic tha:drejtor shumë mir qe ke pregaditur plan punes dhe bdoshta asht mir me prezentue,si organeve ekzekutive dhe kuvendit dhe une te perkrahi.

Spo shoh arsye pse mos me pa atë listë të subvencioneve, a ekziston mundësia për formimin e kooperativave bujqësore apo e ndonjë shoqate bujqësore pasi që nese do të formojshim një shoqatë të tillë shumë më lehtë do të funksionojshim por gjethçka që thuhet është se duhet të jemi në bazë të ligjit.

Kryesuesja tha: do ti shohim mundësit se si janë për formimin e kooperatives, ka fermer që kanë përfituar por kan tokë që punojn me hektar dhe çdo fermer që ka përfituar 3 vjet nuk ka të drejtë që të aplikoj, ndërsa atë që përfitojn dhe i shesin ata persona mendoj se duhet të denohen. Ka pasur bujq që kanë në qumshtë ose krerë gjedhe e jo të ndahen këto paisje më shumë për vota. Koltivatorat janë bërë hitë në Komunën tonë.

Dragan Peric tha: sa i perket listes ju thashë qe mund të ju afroje sa her qe te ket nevoj se ashtë publike,por me duhet te them se ne duhet të subcicionjm ne prodhimin e qumshtit dhe te mishit,unë e kam pregaditur nje plan te punes se si duhet te jet subvecionimi,

Stojan Stanojevic tha:drejtor shumë mir qe ke pregaditur plan punes dhe bdoshta asht mir me prezentue,si organeve ekzekutive dhe kuvendit dhe une te perkrahi.

aplikuar por nuk kanë përfituar subvencione si do të mbajm debate në vendbanimet më të mëdha në mënyr që ti njoftojm se si janë mundësit për aplikim.

Ramush Mehmeti tha: së pari kam një vërejtje për Drejtorin pasi nuk tregoi se vitin e kaluar Kryetari ka formuar një komision dhe komisioni ka bërë kontroll në terren e kam parë vet ku i ka vizituar të gjithë se a i kan makinat bujqësore që i kan përfituar, sa i përket kësaj Kryetari e ka mbajt atë premtim dhe e ka realizuar, sa i perket listes besoj që pasi të përfundoj e gjitha do të jetë publike, ndërsa sa i perket që fermert mos ta marrin ata që kanë përfituar 3 vitet e fundit mendoj se është gabim sepse ai që është fermer ka nevoj për çdo gjë. Komunën e Prishtinës i subvencion edhe Ministria edhe Komuna për grur për miser për të gjitha pasi që çdo subvencionim që bëhet për fermert ne po ia kthejm mjetet atyre.

Stojan Stajonevic tha: para disa diteve kam qenë këtu në Komunë për punë të mija dhe disa qytetarë kanë ardh në Komunë për të kryer punë por kur kan ardhur e kan lexuar në der se nuk punojm për arsye se nuk kemi toner dhe më janë ankuar dhe nuk është në rregull që qytetari të vij disa kilometra e pastaj të kthehet pasi që nuk ka toner.

Pranvera Kastrati Gashi tha: i nderuari drejtor po du me besu që ende nuk është e pregadit lista por kerkoj që mbledhjen tjetër ta kemi listen e perfituesve.

Dragan Peric tha: kjo është për arsye se nuk kemi asnjë bashkpunim në Komunë, nuk kemi bord të Drejtorave, shkoj te Kryetari duhet me prit 1 ore, tjetra qështje është që ne si Drejtori e bujqësisë nuk kemi kushte për punë, disa herë kolegu Avdushi ka blerë vet toner. Të gjitha problemet që i kam unë si Drejtor do të duhej ti prezantoja në bord të drejtorave. Sa i perket asaj liste nuk jam unë fajtor nese do të pergjigjet është komisioni që e ka nënshkruar ose që i ka pranuar kërkesat, vin organizata të ndryshme dhe na thojn se nuk jeni serioze ju si Komunë.

Ramush Mehmeti tha: të kisha lut si drejtor mos na maltreto ne si Kuvend pasi që je Drejtor që të ka zgjedh Kryetari i Komunës nese ty ste pelqen jep dorëheqje, Kryetari i Komunës nese të thot me raportu raporton në Kuvend ne nuk mundë të ofrojm zgjidhje ty.

Pika e gjashtë: të ndryshme;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Dobrivoje Djordjevic tha: kemi kërkuar disa herë dhe mendoj se edhe duhet të bojkutohet puna e Kuvendit në rrugën Stanishor – Strazh kamionat kalojn, më telefonojn qytetarët dhe më shumë po kalojn kamionet. Kjo rrugë duhet të jetë prioritare Stanishor – Prekovic ju keni premtuar ju personalisht se do të punoni në këtë drejtim.

Kryesuesja tha: ne kemi kërkuar raportin se çka ka biseduar Komuna me Ministrin rreth kësaj qështjes së rrugës por atë raport ende nuk e kemi marrë. Qytetarët duhet të mendojn para se ta shesin pronen e vet pasi që kur po shitet prona po ndertohet gurthyesi pastaj po ankohen se pse kamionat po kalojn. Qështja tjetër është se ne kerkojm se a janë këto biznese ilegale apo jo. Ne pjesën e punës duhet ta kryem në kuader të ligjit. Ne si Kuvend duhet ta kerkojm atë që është me ligj.

Abdyl Gashi tha: unë e kam një shqetësim dhe pothuajse e kanë edhe shumica e qytetarëve tonë shumë qytetarë që udhetojn me disa kilometra larg si Pasjak, Stanishor, Kosaq dhe terrene shumë të largëta të cilet vin dhe aplikojn për sherbimet e tyre dhe zyrtaret e kan obligim që tju kryejn sherbime qytetarëve po prej ores 14:00 e kan të pamundur që të marrin sherbime nuk po flas për të gjithë punotrët por shumica e punëtorëve i lirojn venet e tyre të punës dhe e ndjenj venin e punës publik si privat të tyre. Nuk kalon java kur më telefonojn qytetarët dhe lajmrojn se nuk janë puntorët nuk mundë të kryen punë. Unë nuk e di se si shkon funksionimi ose kush e kontorllon id e kartelave në punë, orarin e fillimit dhe përfundimit, kjo qështje duhet të mirret shumë seriozisht pasi është një kosto që ju kushton qytetarëve.

Kjo rrugë duhet të jetë prioritare Stanishor – Prekovic ju keni premtuar ju personalisht se do të punoni në këtë drejtim.

Kryesuesja tha: ne kemi kërkuar raportin se çka ka biseduar Komuna me Ministrin rreth kësaj qështjes së rrugës por atë raport ende nuk e kemi marrë. Qytetarët duhet të mendojn para se ta shesin pronen e vet pasi që kur po shitet prona po ndertohet gurthyesi pastaj po ankohen se pse kamionat po kalojn. Qështja tjetër është se ne kerkojm se a janë këto biznese ilegale apo jo. Ne pjesën e punës duhet ta kryem në kuader të ligjit. Ne si Kuvend duhet ta kerkojm atë që është me ligj.

Abdyl Gashi tha: unë e kam një shqetësim dhe pothuajse e kanë edhe shumica e qytetarëve tonë shumë qytetarë që udhetojn me disa kilometra larg si Pasjak, Stanishor, Kosaq dhe terrene shumë të largëta të cilet

Procesverbali i Kuvendit

Dragan Peric tha: ju kujtohet kur kanë qenë baorët e Strazhes këtu në Kuvend duhet të ju thuhet e verteta njerëzve në rrugë regjionale nuk mundë të nderhyjmë. Mos të ja bëjmë qefin njerzve por te ju thuhet e verteta. E di se si funksion dhe se si respektohet ligji.

Kryesuesja tha: e dini se kemi marrë një vendim që të ju nderprehet puna atyre gurthyesve që nuk kanë dokumentacionin në rregull por Ministria nuk na kanë pranuar atë vendim, do të thërrasim edhe mbledhje të jashtzakonshme në mënyrë që të diskutojm rreth kësaj qështje.

Pasi nuk pati diskutime tjera Kryesuesja i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrje.
Mbledhja përfundoi në ora 11:20.

Procesverbali i Kuvendit

Dragan Peric tha: ju kujtohet kur kanë qenë baorët e Strazhes këtu në Kuvend duhet të ju thuhet e verteta njerëzve në rrugë regjionale nuk mundë të nderhyjmë. Mos të ja bëjmë qefin njerzve por te ju thuhet e verteta. E di se si funksion dhe se si respektohet ligji.

Kryesuesja tha: e dini se kemi marrë një vendim që të ju nderprehet puna atyre gurthyesve që nuk kanë dokumentacionin në rregull por Ministria nuk na kanë pranuar atë vendim, do të thërrasim edhe mbledhje të jashtzakonshme në mënyrë që të diskutojm rreth kësaj qështje.

Valmire Mustafa
Procesmbajtëse



Mirjana Simijonovic
Kryesuese e Kuvendit



Pasi nuk pati diskutime tjera Kryesuesja i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrje.
Mbledhja përfundoi në ora 11:20.

Valmire Mustafa
Procesmbajtëse

Mirjana Simijonovic
Kryesuese e Kuvendit